

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 70, datë 25.06.2024

PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT KRYETARIT TË BASHKISË DURRËS, ZNJ.EMIRIANA SAKO, PËR TË PËRFAQËSUAR BASHKINË DURRËS NË SEANCËN PLENARE PUBLIKE, QË DO TË ZHVILLOHET NË GJYKATEN KUSHTETUESE, LIDHUR ME PROJEKTIN E INVESTIMIT STRATEGJIK “MARINA & JAHTET E DURRËSIT”

Në zbatim të nenit 54, gërma “h” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së autorizimit kryetarit të bashkisë Durrës, znj. Emiriana Sako, për të përfaqësuar Bashkinë Durrës në seancën plenare publike që do të zhvillohet në Gjykatën Kushtetuese, lidhur me projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”, si dhe të hartojë parashtrimet.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë Durrës, znj. Emiriana Sako.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK


Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.06.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 389 prot.
16

Durrës, më 01.07.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.70 datë 25.06.2024 ,” Për dhënien e autorizimit kryetarit të Bashkisë Durrës, znj.Emiriana Sako, për të përfaqësuar Bashkinë Durrës në seancën plenare publike, që do të zhvillohet në gjykatën kushtetuese, lidhur me projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”,

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

